

# KOHA

## HISTORIA E NJË FTESE

Ilir Zherka: MILLOSHEVIQI DO  
TË TAKOHEJ ME RUGOVEN

PROJECT ON  
ETHNIC  
RELATIONS



One Palmer Square  
Suite 405  
Princeton, New Jersey 08542-3718  
USA

To:

- Socialist Party of Serbia,
- Democratic League  
of Kosovo ...



David Hartsaugh: 200 MËNYRA  
TË REZISTENCËS PAQËSORI

PSE NUK MBËRRITI PEJANI NË KULM TË ANDEVE  
MARTESA E PARË E NJË SHQIPTAREJE ME NJË FEMËR

# MARTESA E IGBALLES ME REJÇELIN

*Si u martua Igbalja prishtinase me Rachel-in angleze?*

KOHA \ Prishtinë

Tash së fundi në Parlamentin Evropian është vënë në diskutim mundësia e legalizimit të martesës homoseksuale. Dhe asgjë më tepër. Diskutimet, e besa edhe demonstrimet për këtë problem mbesin përpjekje e kahmotshme e grupacioneve homoseksuale për t'i legalizuar shtytjet e tyre psiko-fizike. Edhe pse diku të lejuara, prapsepapë, përbuzja shoqërore për grupacionet e tilla është ende e themeltë dhe defnitive. Në fund, ajo që nxeu gjakërat e Amerikës konzervative, ishte legalizimi i "dylberëve" në armatë, të cilin e aprovoi dekreti i kryetarit Clinton, i cili me ta fituar mandatin e kryetarit më 1993, për herë të parë lejoi regrutimin e homoseksualëve në armatën më të fuqishme të botës.

## Pranvera lesbiane në Novi Sad

Vetëm gjurmuesit e palodhshëm të shtypit të verdhë dhe, mbase, një armatë e vogël e psikologëve e sociologëve ka dëgjuar dhe lexuar për martesat e lesbianeve, raste të rralla të publikimit dhe zyrtarizimit të marrëdhënieve të palejueshme të civilizimit që njohim. Sa për ne, shqiptarët (apo edhe Ballkanin), diç e tillë ishte e pamundur. Çfarëdo përpjekje për legalizimin e marrëdhënieve të partnerëve homoseksualë është baraz me blasfeminë më të madhe shoqërore.

Për homoseksualët këtu të ne është folur dhe flitet heshtazi dhe me përbuzje përcjellëse. Por, ja që këtyre ditëve Kosova u shënuua vendi i parë në ish-Jugosllavi që u kurorëzua me një martesë lesbiane. E pabesueshme?



Një letër e cila në redaksinë tonë arriti përmes e-mailit tonë ishte përplot njoftime 'romantike' mbi dasmën e pazakonshme e cila kurorëzoi martesën mes dy femrave.

E titulluar "Me një lule s'çel pranvera, por ja që ndodhi" dhe me përfundim çlirues se, më në fund, u hap shtegu i legalizimit të marrëdhënieve të papranueshme, letra e shkruar nga njëfarë Zorica Markeshiq - me gjasë udhëheqëse e një organizate feministe nga Novi Sadi - që përshkrante ahengun 'simpatik' homoseksual, mbeti lajm frapant për akëcilin qytetar i cili e lexoi apo vetëm dëgjoi për të.

Dasma e parë e dy femrave lesbiane ndodhi në Novi Sad të Vojvodinës, me

martesën e një femre shqiptare dhe një angleze: Igballes dhe Rachel-it.

Dhe, pëshpëritet se do të ketë qenë 2 gushti i këtij viti, kur gjatë një tubimi 'gjithëfemëror' në Novi Sad, Igbalja prishtinase mori guximin t'ia shqiptojë "PO"-në fatlume dhe zyrtare dashurisë së vet me Rachel-in.

Për ceremoninë e pazakonshme, thuhet se nuk vuante prej formaliteteve - përveç leximit të ndërsjellë të letrave të dashurisë nga ana e nuseve, apo dhëndërreve, si të doni. Natyrisht, të përcjella me ovacione, lot të gëzimit dhe klithma të shpresës për popullarizimin dhe thyerjen e akullit 'konzervativ' mbi segmentin (kurrë më elastik) të lirive dhe të drejtave të njeriut.

## Kumbaria ndërkombëtare dhe shiu i bereqetshëm...

Sa për kumbarinë. Detyra e shenjtë e dëshmisë së kurorëzimit të kësaj dashurie i takoi Nelës nga Zagrebi dhe Martës nga Kosova. Pohohet se gëzimi arriti kulminacionin kur tufa(t) e luleve, pas "PO"-së vendimtare para altarit bashkëshortor ranë në duart fatbardhe të kandidateve të ardhshme. Pas kësaj, gjithë natën nuk pushoi kënga, vallja dhe ahengu homoseksual. Megjithatë ndodhi!

"Murmëronte dhe vetëtonte", shkruan Zorica e mallëngjyer, "por askush nuk i vënte veshin shiut që skurronte mbi ne. Mbetej vetëm ëndrra e jetësuar dhe dëshira për vazhdimësi. Xhaketa dhe patikat më janë ende të lagura në radiator..."

Ndonjë koment?